

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR
“HARVEST HUB – ALBANIA”

Sot, me date 14.02.2025, në mbështetje të ligjit nr. 38/2012, datë 05.04.2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, hartohet ky akt themelimi prej anëtarëve të shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor SHBB ” HARVEST HUB – ALBANIA ”.

1. JULIAN SHYQYRIU me ID (H70605141I)
2. ARMEND PLAKA me ID (I9090908016C)
3. ENDRIT PEPA me ID (I30627011S)
4. KLAJDI SHOPI me ID (H81203131E)
5. ALBAN HOXHA me ID (I71015016K)
6. KUJTIM FETAHU me ID (G70201305N)
7. ENDRI FUSHA me ID (J00321029C)
8. VASIL HASA me ID (G90107116W)
9. ALEKS FETAHU me ID (I90623016V)

Në mbështetje të ngritjes së inkubatorit në shkollën e mesme profesionale “Mihal Shahini” Cërrik, e cila do të shndërrohet në qendër asistence të SHBB “HARVEST HUB – ALBANIA”.

Kjo shoqëri është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të anëtarëve të saj, jo politike dhe e pavarur.

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emërtimi i shoqërisë do të jetë **Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor “HARVEST HUB – ALBANIA”**.

Inicialet e shoqërisë do të jenë **SHBB “HARVEST HUB – ALBANIA”**.

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor “HARVEST HUB – ALBANIA” për ruajtjen, kultivimin, përpunimin dhe tregtimin e misrit Sulova (Farë Autoktone) është si vijon:



1. Ruajtja dhe përhapja e farës autoktone

Kultivimi dhe rigjenerimi i misrit autokton Sulova.

Realizimi i praktikave bujqësore për kultivimin e misrit Sulova në kushte të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, duke përfshirë mbështetje për fermerët në prodhimin e farës nën asistencën e shkollës së mesme profesionale “Mihal Shahini” Cërrik.

2. Ruajtja e biodiversitetit dhe vlerave tradicionale të farës së misrit Sulova

Ruajtja e farës autoktone dhe promovimi i kultivimit të misrit si pjesë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

3. Prodhimi dhe përpunimi i misrit

Prodhimi i misrit për konsum dhe për përdorim si farë.

Përpunimi i produktit në forma të ndryshme (miell, ushqim për blegtorinë, etj.) duke siguruar që cilësia dhe siguria e produkteve të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

4. Certifikimi dhe standardizimi

Sigurimi i cilësisë dhe autenticitetit të farës autoktone.

Certifikimi për të garantuar që fara e misrit Sulova të jetë autentike.

Monitorimi dhe implementimi i standardeve të larta të cilësisë dhe siguri së ushqimore në procesin e prodhimit dhe përpunimit të misrit, duke u siguruar që produktet të përmbushin kërkesat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar.

5. Eksperimentimi dhe inovacioni

Studime për rritjen e rendimentit dhe rezistencës së misrit.

Eksperimentime për të përmirësuar karakteristikat e varietetit të farës së misrit, si dhe për të rritur rezistencën ndaj kushteve të ndryshme klimatike dhe sëmundjeve.

Bashkëpunim me institucione shkencore dhe bujqësore për përmirësimin e varietetit.

Bashkëpunime për të zhvilluar varietetet më të mira të misrit dhe për të siguruar transferimin e njohurive dhe teknologjive më të fundit në sektorin bujqësor.

6. Bashkëpunimi dhe promovimi

Partneritete me fermerë dhe institucione bujqësore për rritjen e prodhimit.

Rrjetet e bashkëpunimit me fermerët, organizatat bujqësore dhe institucionet lokale për të rritur kapacitetet e prodhimit dhe për të mundësuar një mbështetje të qëndrueshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Promovimi i misrit Sulova si një produkt autokton me vlera të larta ushqimore.

Marketimi për të rritur njohjen e misrit Sulova dhe promovimin e tij si një produkt me vlera të larta ushqimore.



7. Shitja dhe marketingu

Zhvillimi i rrjeteve të shpërndarjes dhe tregtimit të farës dhe produkteve të misrit.

Pjesëmarrja në panaire dhe tregje për të rritur njohjen dhe vlerësimin e këtij produkti.

NENI 3

SELIA DHE TERRITORI I VEPRIMTARISË

Selia e shoqërisë do të jetë në shkollën e mesme profesionale “Mihal Shahini”, me adresë: Lagjja nr 2, Rruga “Gjimnazistët”, Cërrik.

Veprimtaria e saj do të shtrihet në Qarkun Elbasan si dhe kudo ku shtrihet anëtarësia e saj.

NENI 4

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

NENI 5

KAPITALI

Kapitali i shoqërisë përbëhet minimalisht nga 100 000 (njëqind mijë) lekë i ndarë në përqindje sipas kontributit të secilit anëtar.

Kapitali mund të derdhet me para në dorë ose në kontribute në natyrë (objekte, tokë ose makineri bujqësore).

Kontributet në natyrë shprehen në vlerë ekonomike mbi bazën e një raporti vlerësimi të bërë nga një ekspert i caktuar nga asambleja e përgjithshme.

Anëtarët janë pronarë të aseteve të tyre në kapitalin e shoqërisë duke qenë kështu dhe pronarë të shoqërisë në raport me kontributet në kapital.

Kapitali përkatës mund të shitet, dhurohet apo lihet në trashëgimi nga secili prej anëtarëve të shoqërisë.

Në momentin e krijimit të shoqërisë kapitali fillestar është i ndarë si më poshtë:

- | | |
|--------------------|-----|
| 1. JULIAN SHYQYRIU | 20% |
| 2. ARMEND PLAKA | 10% |
| 3. ENDRIT PEPA | 10% |
| 4. KLAJDI SHOPI | 10% |

- | | |
|------------------|-----|
| 5. ALBAN HOXHA | 10% |
| 6. KUJTIM FETAHU | 10% |
| 7. ENDRI FUSHA | 10% |
| 8. VASIL HASA | 10% |
| 9. ALEKS FETAHU | 10% |

(TOTALI =100%)

Shkolla e mesme profesionale "Mihal Shahini" Cërrik do të vërë në dispozicion të shoqërisë mjediset për realizimin e takimeve.

NENI 6

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë:

1. Asambleja e përgjithshme;
2. Administratori i cili me vendim të asamblesë mund të qëndrojë në detyrë për një periudhë kohe maksimale jo më shumë se 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Administratori i miratuar nga mbledhja themeluese e shoqërisë emërohet **z. Julian Shyqyriu**, i cili emërohet administrator për një periudhë 5 vjeçare.

Administratori ngarkohet me kryerjen e të gjitha procedurave të regjistrimit të shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 7

MËNYRA E SHPËRNDARJES SË SHOQËRISË

Shoqëria shpërndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme të thirrur nga administratori.


Procedura e ndjekur për shpërndarjen e saj përcaktohet në Statutin e shoqërisë.

Shoqëria shpërndahet në këto raste;

- Kur numri i anëtarëve është nën 7 (shtatë) persona.
- Kur qëllimi i saj është përmbushur apo nuk ka mundësi të përmbushet, pasi ka humbur aftësinë paguese.
- Në rast shpërndarjeje të shoqërisë, ajo pushon veprimtarinë e saj dhe kalon në likuidim, i cili kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në QKB. Në këtë ditë shoqëria njihet edhe si person juridik.

Të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë e ka administratori i saj ose një person i autorizuar prej tij.



ANËTARËT THEMELUES

1. JULIAN SHYQYRIU

Julian Shyqyriu

2. ARMEND PLAKA

Armend Plaka

3. ENDRIT PEPA

Endrit Peza

4. KLAJDI SHOPI

Klajdi Shopi

5. ALBAN HOXHA

Alban Hoxha

6. KUJTIM FETAHU

Kujtim Fetahu

7. ENDRI FUSHA

Endri Fusha

8. VASIL HASA

Vasil Hasa

9. ALEKS FETAHU

Aleks Fetahu